



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETAR I UJIT**  
**KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE", VLORE**

---

**VENDIM**

Nr. 1, Dt. 20.01.2009

*Per miratim leje, per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Vjose, ne nje mjedis teresisht lumor, ne afersi te fshatit Qesarat (ne lindje te tij) komuna Qesarat, Qarku Gjirokaster, subjektit "Alban Tirana Compani" sh.p.k, Tirane.*

Ne zbatim te kerkesave qe percakton Ligji Nr.8093 Dt. 21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", konkretisht, neni 8 dhe 20, vendimit nr. 1 dhe nr. 3, dt.21.06.2006, te K.K.U-se, si dhe vendimit nr.2 dt. 07.06.2007 te K.K.U-se, duke gjykuar mbi kerkesen dhe studimin e paraqitur nga subjekti "Alban Tirana Compani" sh.p.k, Tirane, konform formularit "E", pasqyruar dhe ne relacionin shoqerues, paraqitur nga A.U.B "Vjose".

Keshilli i Basenit Ujembledhes "Vjose",

**VENDOSI:**

- 1- Te miratoj lejen, per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Vjose, ne afersi te fshatit Qesarat (ne lindje te tij), Komuna Qesarat, Qarku Gjirokaster, subjektit "Alban Tirana Compani" sh.p.k. Tirane.
- 2- Siperfaqja e dhene ne shfrytezim (per 5 vjet) do te jete 0.3 km<sup>2</sup>.  
E kufizuar nga piketat, me koordinata si me poshte.

|                 |                 |
|-----------------|-----------------|
| X 1 = 44 72 570 | Y 1 = 44 05 160 |
| X 2 = 44 72 840 | Y 2 = 44 05 300 |
| X 3 = 44 72 360 | Y 3 = 44 06 200 |
| X 4 = 44 72 080 | Y 4 = 44 06 060 |
- 3- Leja e shfrytezimit jepet per 5 vjet, me te drejte rinovimi cdo 3 vjet.
- 4- Koha e shfrytezimit te zones do te jete ajo e percaktuar ne vendimin nr.1, dt. 21.06.2006 te K.K.U-se, nga dt.01.06 deri me 31.10, te cdo viti.
- 5- Volumi i materialit qe do te merren per 3 vjet do te jete 150 000 m<sup>3</sup>, me nje mesatare vjetore 50 000 m<sup>3</sup>/vit, brenda zones qe jepet ne shfrytezim, thellesia e shfrytezimit deri ne 1.5 m, por jo me shume se 0.5 m mbi pasqyren e ujrave fratike.

- Vazhdim i Vendimit Nr. 1, Dt. 20.01.2009.

6- Ngarkohet A.U.B “Vjose” per zbatimin e ketij vendimi.

7- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

**PERGJEGJES I A.U.B-se “VJOSE”**  
**Vezir METAJ**



**KRYETARI I K.B.U “VJOSE”**  
**Hasan HALILI**

